



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA  
GOVERNMENT OF KOSOVA

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA		INSTITUTI I HISTORISË - INSTITUTE OF HISTORY - INSTITUT ZA ISTORIJU	
Njësia Org. Org. Unit.	1. H	Nr. l. prot. Prot. N.	01/112/24
Org. Jed.		Br. Prot.	
Nri. Faqëve No. Pages Br. Stranica	5	Data: Date: Datum:	18.12.24
PRISHTINË - A			



INSTITUTI I HISTORISË "ALI HADRI" - PRISHTINË  
INSTITUTE OF HISTORY "ALI HADRI" - PRISHTINA  
INSTITUT ZA ISTORIJU "ALI HADRI" - PRISHTINA

Prishtinë, 18.12.2024

## REFERATI I KOMISIONIT

*për zgjedhjen e kandidatit për vendin e punës:  
Bashkëpunëtor shkencor për shek. XIX fillimin e shek. XX - zgjedhje*

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore – Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" në Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenit 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë dhe akteve të tjera përkatëse, vendimit të Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë në mbledhjen e mbajtur më 27.11.2024, për caktimin e Komisionit Recensues Profesional për vendin e punës *Bashkëpunëtor shkencor për shek. XIX fillimin e shek. XX - zgjedhje*, në përbërje: Prof. Asoc. Dr. Fitim Rifati - kryetar, Prof. Asoc. Dr. Mead Osmani - anëtar, Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti - anëtar, dhe Konkursit të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë, të shpallur më 28.11.2024 në faqen e internetit të Institutit: <https://ih-rks.org/konkurs-28-11-2024/> dhe në të përditshmen "Epoka e Re": <https://www.epokaere.com/wp-content/uploads/2024/11/Epoka-28-nentor-2024.pdf>.

Komisioni Recensues ka nderin t'i paraqesë Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë këtë:

### REFERAT *për kandidaten*

Mbështetur në dokumentet ligjore të theksuara më sipër dhe në dosjet e dorëzuara, Komisioni Recensues ka konstatuar se në konkursin për vendin e punës *Bashkëpunëtor shkencor për shek. XIX fillimin e shek. XX - zgjedhje*, ka konkurruar vetëm një kandidate: dr. Ardita Hajdari Buqinca.

Pas verifikimit të dokumentacionit relevant, të nevojshëm dhe të dëshmuar në CV të kandidates, Komisioni Recensues ka konstatuar se kandidatja i plotëson kushtet formale juridike për t'iu nënshtruar procedurave të vlerësimit dhe përzgjedhjes për këtë vend pune.

Sa i përket shqyrtimit të dosjes së kandidates mbi botimet e veçanta, publikimet e punimeve në revista shkencore dhe pjesëmarrjen në konferenca e aktivitete shkencore brenda e jashtë vendit, janë shqyrtuar vetëm ato nga tetori i vitit 2020.

## 1. SHËNIME BIOGRAFIKE TË KANDIDATES

**Ardita Hajdari** Buqinca u lind më 17.12.1987 në Mitrovicë. Studimet themelore (2011), studimet master (2014) dhe studimet e doktoratës (2024) i ka kryer në Universitetin e Prishtinës, Fakulteti Filozofik, Drejtimi i Historisë, në Programin e Historisë së Kohës së Re. Nga 11 gushti i vitit 2011 është në marrëdhënie pune në Institutin e Historisë “*Ali Hadri*” në Prishtinë si hulumtuese dhe hulumtuese e pavarur për shek. XIX-XX. Fusha dhe periudha e interesimeve shkencore të kandidatës Ardita Hajdari Buqinca është Historia e Kohës së Re, me fokus të veçantë shek. XIX fillimi i shek. XX. Është e martuar dhe jeton në Fushë Kosovë.

## 2. VLERËSIMI I PUNËS SHKENCORE

Sipas Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve në Institutin e Historisë “*Ali Hadri*” (në tekstin e mëtejme: Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes...), neni 5, pika 1.3.1 dhe Shtojca I, pika A.2.1 dhe A.2.2, tabela 1.1, kandidatja dr. Ardita Hajdari Buqinca ka këto punime të publikuara në revista, të cilat janë të indeksuara në bazat akademike dhe barasvlerësohen me 1:

Nr	Emri dhe mbiemri i autorit	Titulli i punimit	Revista	Vëll., nr., (viti), faqet	Linku i publikimit
1.	Ardita Hajdari & Nuri Bexheti	Albanian Press on the Efforts of Cooperation between Kosovo Albanians and the Bulgarians of Macedonia (1912-1914)	<i>Balkanistic Forum</i>	nr. 1, 2024, p. 58-71	<p>Linku i publikimit të punimit:</p> <p><a href="https://www.scopus.com/sourceid/21100464913">https://www.scopus.com/sourceid/21100464913</a></p> <p><a href="https://doi.org/10.37708/bf.swu.v33i1.6">https://doi.org/10.37708/bf.swu.v33i1.6</a></p> <p><a href="https://www.webofscience.com/wos/woscc/full-record/WOS:001165974100001">https://www.webofscience.com/wos/woscc/full-record/WOS:001165974100001</a></p> <p><a href="https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=1212961">https://www.ceeol.com/search/article-detail?id=1212961</a></p> <p><a href="https://www.scopus.com/results/authorNamesList.uri?sort=count-f&amp;src=al&amp;sid=eab1009364363412f0f6df2df3a2419e&amp;sot=al&amp;sdt=al&amp;sl=43&amp;s=AUTHLASTNAME%28Hajdari%29+AND+AUTHFIRST%28Ardita%29&amp;st1=Hajdari&amp;st2=Ardita&amp;orcidId=&amp;selectionPageSearch=anl&amp;resellectAuthor=false&amp;activeFlag=true&amp;showDocument=false&amp;resultsPerPage=20&amp;offset=1&amp;jtp=false&amp;currentPage=1&amp;previousSelectionCount=0&amp;tooManySelections=false&amp;previousResultCount=0&amp;authSubject=LFSC&amp;authSubject=HLSC&amp;authSubject=PHSC&amp;authSubject=SOSC&amp;exactAuthorSearch=false&amp;showFullList=false&amp;authorPreferredName=&amp;origin=searchauthorfreelookup&amp;affiliationId=&amp;txGid=29e98f2c55156673389307b47dc94a76">https://www.scopus.com/results/authorNamesList.uri?sort=count-f&amp;src=al&amp;sid=eab1009364363412f0f6df2df3a2419e&amp;sot=al&amp;sdt=al&amp;sl=43&amp;s=AUTHLASTNAME%28Hajdari%29+AND+AUTHFIRST%28Ardita%29&amp;st1=Hajdari&amp;st2=Ardita&amp;orcidId=&amp;selectionPageSearch=anl&amp;resellectAuthor=false&amp;activeFlag=true&amp;showDocument=false&amp;resultsPerPage=20&amp;offset=1&amp;jtp=false&amp;currentPage=1&amp;previousSelectionCount=0&amp;tooManySelections=false&amp;previousResultCount=0&amp;authSubject=LFSC&amp;authSubject=HLSC&amp;authSubject=PHSC&amp;authSubject=SOSC&amp;exactAuthorSearch=false&amp;showFullList=false&amp;authorPreferredName=&amp;origin=searchauthorfreelookup&amp;affiliationId=&amp;txGid=29e98f2c55156673389307b47dc94a76</a></p>

2.	Ardita Hajdari Buqinca	Aspekte shoqërore, politike dhe kulturore në prag të kryengritjes së vitit 1910 në Kosovë në dritën e shtypit shqiptar	Kosova	Nr. 48, (2023), f.51-60.	Linku i publikimit të punimit: <a href="https://albanica.al/revista_kosova/article/view/3716">https://albanica.al/revista_kosova/article/view/3716</a>
----	------------------------	--	--------	--------------------------	---

Sipas Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes..., neni 5, pika 1.3.2 dhe Shtojca II, pika A, tabela 1.2, kandidatja dr. Ardita Hajdari Buqinca ka të publikuar (në proces shtypi në shtypshkronjë) këtë monografi studimore në gjuhën shqipe:

Nr.	Autori/autorët	Titulli	Lloji i botimit	Botuesi	Vendi dhe viti
1.	Ardita Hajdari Buqinca	Shtypi shqiptar për lëvizjet e armatosura në Kosovë 1908-1924	Monografi studimore	Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë	Prishtinë, 2024

Sipas Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes..., neni 5, pika 1.4 dhe Shtojca II, pika B, tabela 1.1, kandidatja dr. Ardita Hajdari Buqinca ka këto publikime nga konferenca shkencore ndërkombëtare (jashtë vendit):

Nr.	Autori/Autorët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr. (viti), faqet
1.	Ardita Hajdari Buqinca & Miftar Kurti	Shtypi francez për veprimtarinë e Hasan Prishtinës në vitin 1912	Shqiptarët dhe ndërkombëtarët në vitet 1912-1926	Akademia e Studimeve Albanologjike – Instituti i Historisë, Tiranë & Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë Tiranë	(2021), f.25-33.
2.	Ardita Hajdari Buqinca	Jeta dhe veprimtaria e dëshmores Fatime Hetemi	Roli i grave në jetësimin e shtetit të Kosovës	Instituti i Historisë "Ali Hadri" - Prishtinë	(2024), f.289-293.

Sipas Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes..., neni 5, pika 1.4 dhe Shtojca II, pika B, tabela 1.2, kandidatja dr. Ardita Hajdari Buqinca ka këtë publikim nga konferenca në nivel vendor:

Nr.	Autori/Autorët	Titulli i punimit	Konferenca, simpoziumi	Botuesi dhe vendi	Vëllimi, nr (viti), faqet
1.	Miftar Kurti & Ardita Hajdari Buqinca	Krimet e forcave serbe në komunën e Mitrovicës (1998-1999)	Konferencë shkencore “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”, organizuar nga Instituti i Historisë - Prishtinë, Instituti i Historisë - Tiranë, Instituti Albanologjik Prishtinë	Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë	(2024), f.447-468.

Sipas Rregullores për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes..., neni 5, pika 1.4 dhe Shtojca II, pika C, tabela 1.1, ka këto prezantime gojore-shkencore në konferenca, simpoziume, punëtori shkencore dhe në universitete (si ligjërues i ftuar) nga fusha e kandidatit:

Nr.	Autori/Autorë /Prezantuesi	Titulli i kumtesës	Emri i konferencës, simpoziumit, organizatori	Vendi dhe viti
1.	Ardita Hajdari Buqinca & Miftar Kurti	Shtypi francez për veprimtarinë e Hasan Prishtinës në vitin 1912	Konferencë Shkencore “Shqiptarët dhe ndërkombëtarët 1912-1926”, organizuar nga Akademia e Studimeve Albanologjike - Instituti i Historisë & Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë	Tiranë, 25 tetor 2019
2.	Miftar Kurti & Ardita Hajdari Buqinca	Krimet e forcave serbe në komunën e Mitrovicës (1998-1999)	Konferencë Shkencore “Gjenocidi serb kundër shqiptarëve gjatë shek. XIX-XX”, organizuar nga Instituti i Historisë - Prishtinë, Instituti i Historisë - Tiranë, Instituti Albanologjik - Prishtinë	Prishtinë, 7-8 prill 2022
3.	Ardita Hajdari Buqinca	Jeta dhe veprimtaria e dëshmores Fatime Hetemi	Konferenca Shkencore Ndërkombëtare “Roli i grave në jetësimin e shtetit të Kosovës (Aspekte sociale, kulturore dhe politike nga viti 1980 deri në ditët e sotme)”, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë	Prishtinë, 5 maj 2023
4.	Ardita Hajdari Buqinca	Dhuna dhe terrori serbo-malazez në Kosovë (1912-1913) sipas shtypit shqiptar	Konferenca Shkencore “Çështja shqiptare në Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1912-1913)”, organizuar nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” - Prishtinë & Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” – Fakulteti Filozofik, Departamenti i Historisë	Prishtinë, 26 tetor 2023

Ardita Hajdari Buqinca, gjatë detyrës si Hulumtuese e pavarur në Institutin e Historisë “*Ali Hadri*” - Prishtinë ka qenë aktive në veprimtarinë botuese, kërkimore-shkencore e aktivitete profesionale, si dhe ka kryer me sukses studimet e doktoratës. Komisioni vlerëson se ajo e ka përmbushur me rezultate konkrete detyrën e saj prej Hulumtueses së pavarur për periudhën e shek. XIX dhe fillimin e shek. XX në kuadër të Institutit të Historisë “*Ali Hadri*” në Prishtinë.

## KONKLUZION

Mbështetur në dokumentacionin e nevojshëm dhe kushtet e konkursit të shpallur më 28.11.2024 në faqen e internetit të Institutit të Historisë “*Ali Hadri*” - Prishtinë dhe në të përditshmen “*Epoka e Re*”, si dhe duke u bazuar në Ligjin nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore – Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), Statutin e Institutit të Historisë “*Ali Hadri*” në Prishtinë (01B-195, të datës 31.10.2024), nenin 8 të Ligjit të Punës nr. 03/L212, Rregulloren për Procedurat e Zgjedhjes dhe Rizgjedhjes së Punëtorëve Shkencorë dhe Hulumtuesve të Institutit të Historisë “*Ali Hadri*” – Prishtinë dhe akteve të tjera përkatëse, Komisioni Recensues ka arritur në këtë konkluzion:

Marrë për konsideratë rezultatet e punës shkencore, përgatitjen adekuate mbi periudhën e kërkuar në konkurs, botimin e monografisë, punimet shkencore të fushës përkatëse të botuara në organe revistash relevante kombëtare e ndërkombëtare, pjesëmarrjen në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, Komisioni Recensues ka arritur në përfundimin se kandidatja dr. Ardita Hajdari Buqinca ka të arritura të profilizuara mbi periudhën e shek. XIX fillimin e shek. XX. Ajo e ka kualifikimin dhe përvojën e duhur, që i mundësojnë ushtrimin me kompetencë të pozitës së kërkuar me konkurs.

### 3. PROPOZIMI PËR ZGJEDHJE

**Komisioni Recensues**, bazuar në kushtet e konkursit, kriteret ligjore e nënligjore dhe të arriturat profesionale, njëzëri i propozon **Këshillit Shkencor të Institutit të Historisë “*Ali Hadri*” - Prishtinë**, që kandidatja **dr. Ardita Hajdari** të zgjedhet për vendin e punës **Bashkëpunëtor shkencor për shek. XIX fillimin e shek. XX**.

**Komisioni Recensues:**

Prof. Asoc. Dr. Fitim Rifati, kryetar



Prof. Asoc. Dr. Mead Osmani, anëtar



Prof. Asoc. Dr. Nuri Bexheti, anëtar

